

SPECIFIKEME TEKNIKE

OBJEKTI:”REHABILITIMI DHE SISTEMIMI I TUBACIONEVE TE UJRAVE TE ZEZA DHE GROPAVE SEPTIKE(PASTRIM THITHJE ZHBLLOKIM)NE TERRITORIN E ADMINISTRUAR NGA U.K SHA SARANDE”.

KAPITULLI – I

TE PERGJITHESHME

Te pergjitheshme

Paragrafet ne kete kapitull jane plotesuese te detajeve te dhena ne Kushtet e Kontrates.

Dokumentat dhe vizatimet

Kontraktori do te verifikojte te sasis dhe vellimet te treguar ne Vizatimet, Grafiket,ose te dhena te tjera dhe Punedhenesi nuk do te mbaje pergjegjesi per ndonje mangesi ose mosperputhje te gjetur ne to. Mos zbulimi ose korrigjimi i gabimeve ose mosperputhjeve nuk do ta lehtësoje Kontraktorin nga pergjegjesia per pune te pakenaqeshme .Kontraktori do te marre persiper te gjithë pergjegjesine ne berjen e llogaritjeve sasive dhe volumeve te materjaleve dhe pajisjeve te perfshira ne punen qe duhet bere sipas Kontrates. Ai nuk do te lejohet te kete avantazhe nga ndonje gabim ose mosperputhje, ndersa nje udhezim i plote do te jepet nga Punedhenesi ne se gabime te tilla ose mosperputhje do te zbulohen.

Kostot e kontraktorit per mobilizimin dhe punimet e perkoheshme

Do te kihet parasysh qe Kontraktori nuk do ti behet asnje pagese mbi cmimet njesi te kuotuar per kostot e mobilizimit d.m.th. per sigurimin e transportit, drite, energjiine ,veglat dhe pajisjet,ose per furnizimin e godines dhe mirembajtjen e impjanteve te ndertimit,rrugeve te hyrjes,te komoditeteve sanitare heqje e mbeturinave, punen, furnizimin me uje, mbrojtjen kundra zjarrit, bangot e punes, rojet, rrjetin telefonik si dhe struktura te tjera te perkoheshme, pajisje dhe materjale, ose per kujdesin mjeksor dhe mbrojtjen e shendetit, ose per patrullat dhe rojet, ose per ndonje sherbim tjetër, lehtësi, gjera, ose materjale te nevojshme ose qe kerkohen per zbatimin e punimeve ne perputhje me ate qe eshte parashikuar ne Kontrate.

Hyrja ne sheshin e sherbimit

Kontraktori duhet te organizoje punen per pastrimin,mirembajen dhe me pas te spostoje dhe ta rivendose cdo pusët dhe kapak te gopave septike qe do te duhet ne lidhje me zbatimin e punimeve . Hyrje dhe daljet ne sheshine sherbimitnga kontraktori te shkaktoje sa me pake papasterti dhe te evitoje rrjedhje te mundeshme te ujrave te pusetave apo gropave septike te pastruara.

Furnizimi me uje

Uji qe nevojitet per zbatimin e punimeve do te merret nga rrjeti kryesor nepermjet nje matesi ne piken me te afert te mundeshme..Kontraktori do te shtriye rrjetin e vet te perkoheshem te tubacioneve . Lidhjet me rrjetin kryesor dhe kostot per kete do te pagohen nga Kontraktori. Ne rastet kur nuk ka mundesi lidhje me rrjetin kryesor, Kontraktori duhet te beje vete perpjekjet per furnizimin me uje higjenikisht te paster dhe te pijshem per punetoret dhe punimet.

Piketimi i punimeve

Kontraktori , me shpenzimet e tij duhet te beje ndertimin e modinave dhe te piketave sic kerkoet, ne perputhje me informacionin baze te Punedhenesit,dhe do te jete pergjegjesi i vetem per perpikmerine. Kontraktori do te jete pergjegjes per te kontrolluar dhe verifikuar informacionin baze qe i eshte dhene dhe ne asnje menyre nuk do te lehtesohet nga pergjegjesia e tij ne se nje informacion i tille eshte i manget, jo autentik ose jo korrekt . Ai nderkohe do te jete subjekti qe do te kontrollohet dhe rishikohet nga Punedhenesi ,dhe ne asnje rast nuk i jepet e drejta te beje ndryshime ne vizatimet e kontrates , per asnje lloj kompensimi per korrigjimet e gabimeve ose te mangesive .Kontraktori do te furnizojë dhe mirembaje me shpenzimet e tij, rrethimin dhe materiale te tjera te tilla dhe te jape asistencëKontraktori do te ruaje te gjitha pikat e pastrimit, kapaket epusetave dhe gropat septike, tembuloje koston e rivendosjes se tyre nese ato demtohen dhe te mbuloje te gjitha shpenzimet per ndreqjen e punes sebere jo mire per shkak te mosmirembajtjes ose mbrojtjes ose spostimit pa autorizim te ketyre pikave te vendosura,modinave dhe piketave.Perpara cdo aktiviteti sherbimi, Kontraktori do te kete linjat e furnizimit me uje, te drejten e kalimit te qarte dhe te sheshuar per ne pikat e kerkuara, gati per fillimin e punimeve. Cdo pune e bere jasht akseve,kuotave dhe kufijve te treguara ne vizatime ose te mosmiratuara nga Punedhenesi nuk do te paguhet, dhe Kontraktori do te mbuloje me shpenzimet e tij punimet shtese gjithmone nen drejtimin e Menaxherit te Projektit.

Fotografite e sheshit te sherbimit

Kontraktori duhet te beje forografi me ngjyra sipas udhezimeve te Menaxherit te Projektit ne vendet e punes per tedemostruar kushtet e sheshit perpara fillimit , progresin gjate punes se sherbimit dhe mbas perfundimit te punimeve.Nuk do te behen pagesa per fotografimin e kantierit te punimeve pasi keto shpenzime jane parashikuar te mbulohennen koston administartive te Kontraktorit.

Bashkepunimi ne zone

Sherbimi do te behet ne zone e percaktuar nga punedhenesi. Kontraktori duhet te kete vecanerisht kujdes ne:

- a) nevojen per te mirembajtur sherbimet ekzistuese dhe mundesite e kalimit per banoret dhe tregetaret qejane ne zone gjate periudhes se ndertimit.
 - b) prezencen e mundeshme te kontraktoreve te tjere ne zone me te cilet do te koordinohet puna.
- E gjithë puna do te behet ne nje menyre te tille qe te lejoje hyrjen dhe perballimin e te gjithë pajisjeve te mundeshmeper ndonje Kontraktor tjetër dhe punetoreve te tij, stafin e Punedhenesit si edhe te cdo punojnjesi qe mund tepunesohet ne zbatim dhe/ose punimet ne zone ose prane saj per cdo objekt qe ka lidhje me Kontraten ose cdo gjetjeter.

Ne pregatitjen e programit te tij te punes Kontraktori gjate gjithë kohes do te beje llogari te plote dhe do te kooprojeme programin e punes se Kontraktoreve te tjere ne menyre qe te shkaktoje nje minimum interference me ta dhe mepublikun.

Mbrojtja e punes dhe e publikut

Kontraktori do te mare masa paraprake per mbrojtjen e punetoreve te punesuar dhe te jetes publike si edhe tepasurive ne dhe rreth sheshit te sherbimit. Masat e sigurimit paraprak te ligjeve te aplikushme, realizimine e punimeve sipas standarteve te kerkuara. Makinerite, pajisjet dhe cdo rrezik do te kqyren ose eliminohen ne perputhje memasat paraprake te sigurimit.Gjate zbatimit te punimeve Kontraktori, me shpenzimet e veta, duhet te vendosi dhe te mirembaje gjate natespengesa te tilla dhe drita te cilat do te parandalojne ne menyre efektive aksidentet. Kontraktori duhet te sigurojepengesa te pershtateshme, shenja me drite te kuqe “rrezik” ose “kujdes” dhe vrojtues ne te gjitha vendet ku punimetmund te shkaktojne crregullime te trafikut normal ose qe perbejne ne ndonje menyre rrezik per publikun.

Mbrojtja e ambientit

Kontraktori, me shpenzimet e veta, duhet te ndermarre te gjithë veprimet e mundshme per te siguruar qe ambjentilokal i sheshit te ruhet dhe qe vijat e ujit, toka dhe ajri (duke perfshire edhe zhurmat) te jene te pastra nga ndotja pershkak te punimeve te kryera . Mos plotesimi i kesaj klauzole ne baze te evidentimit nga Menaxheri i Projektit, mund tecoje ne nderprerjen e kontrates.

Transporti

Transporti i cdo materjali nga Kontraktori do te behet me makina te pershtateshme te cilat kur ngarkohen nukshkaktojne derdhje dhe e gjithë ngarkesa te jete e siguruar. Ndonje makine qe nuk ploteson **kete kerkese** ose ndonjenga rregullat ose ligjet e qarkullimit nuk do te mari pjes ne pikat e **percaktuar te sherbimit**. Transporti i matrialit duhet te permbushi te gjitha satndartet mjedisore te kerkuara nga Instucionet **perkatese** dhe te permbushi te gjitha kerketat ligjore te miratuar per transportin dhe ruajrjen e lendeve ndotese.

Kopjimi i vizatimeve (Vizatimet siç eshte zbatuar)

Kontraktori duhet te pergatise vizatimet per te gjitha punimet “siç jane faktikisht zbatuar” ne terren. Vizatimet do te behen ne nje standart te ngjashem me ate te vizatimeve te Kontrates. Gjate zbatimit te punimeve sheshine esherbimit. Kontraktori do te ruaje te gjithë informacionin e nevojshem per pergatitjen e “Vizatimeve siç eshte zbatuar”. Do te shenoje ne menyre te qarte vizatimet dhe te gjitha dokumentat e tjera te cilat mbulojne punen e vazhdueshme te perfunduar, material i cili do te jete i disponueshem ne **cdo kohe gjate zbatimit per Menaxherin e Projektit**. Keto vizatime do te azhurnohen ne menyre te vazhdueshme dhe do ti dorezohen Menaxherit te Projektit cdo muaj per aprovim, pasi punimet te kene perfunduar, sebashku me kopjen perfundimtare. Materiali do te dorezohet ne kopje leter. Vizatimet e riprodhuara do te perfshijne pozicionin dhe situatene pikes se sherbimit, te lena gjate pastrimit dhe zhvendesjes se matrialit.. Si perfundim, kopjet e riprodhuara te Vizatimeve “ siç eshte zbatuar” do t'i dorezohen Menaxherit te Projektit per aprovim. Vizatimet “siç eshte zbatuar” ,te aprovuara, do te behen prone e Punedhenesit. Nuk do te behen pagesa per berjen e Vizatimeve “siç eshte zbatuar” dhe Manualeve, pasi kosto e tyre eshte parashikuar te mbulohet nga shpenzimet administrative te Kontraktorit.

Pastrimi perfundimtar i zones

Ne perfundim te punes, sa here qe eshte e aplikueshme Kontraktori, me shpenzimet e tij, duhet te pastroje dhe te heqe nga sheshi materialet qe kane tepruar, mbeturinat, rrjedhje te mu ndeshme te matrialit te ujrave te ndotura dhe ndertimet e perkoheshme te cdo lloji, dhe te lere sheshin e tere dhe veprat te pastra dhe ne kondita te pranueshme. Pagesa perfundimtare e Kontrates do te mbahet deri sa kjo te realizohet dhe pasi te jepet miratimi nga Menaxheri i Projektit.

KAPITULLI - II

PUNIME NE TUBACIONE TE UJRAVE TE ZEZA

Thithje e matrialit te ngurte.

Kontraktori duhet te kryej te gjitha punimet per pastramin e ujrave te zeza duke hequr matrialin e ngurte me thithje me sonde ne cdo pike sherbimi te percaktuar ne dokumentat dhe skicimet e pergatituar nga Punedhenesi. Gjate punime matrialine ngurte te hequr kontraktori duhet ta transportoje ne vende te percaktuara dhe te licensuara, dhe ne cdo raste te shmangi ndotjen e e ambientit brenda dhe jashte qytetit te Sarandes.

Pastrimi I tubacionit te ujrave te zeza

Kontraktori duhet te realizoje pastrimin e tubacionit sipas kushteve te specifikuara nga Punedhenesi per gjatesin dhe dimensi e tubacionit te percatur ne dokumentat dhe skicimet perkatese. Pas pastrimit dhe thithjes se matrialit te ngurt nga tubacioni Kontraktori do te shplaj tubacionin me uje me presion per pastrimin perfundimtar te tij. Cdo sasi uji apo matriali I ngurte qe ngelet nga pastrimi do te thithet me sonde nga makinerit e Kontraktorit.

Pastrimi I gropave Septike

Kontraktori do te realizoje pastrimin e cdo grope septike te percaktuar ne dokumenta dhe skica nga Punedhenesi. Matriali I gropave do te thithet nga makineri te pershtashme per pastrim e gropave dhe larja e gropave ne brendesi me uje te rrjedheshem per pastrim kapiatal te tyre. Pastrimi dhe mirmabajtja e ketyre gropave gjate sherbimit do te realizohet nga Kontraktori sipas kushteve te percaktuar ne dokumenta.

PUNOI :

Ing.Arch. Edmond Rumani
Ing.Mjedisi. Algert Bajrami

MIRATOHET

Per U.K.shaSARANDE
Admin.Ing.Sheme LULO